

Përvetësimi i gjuhës shqipe si gjuhë amtare nga pikëvështrimi i hipotezës së rendit natyror

Xhavit Rexhaj¹ Prof. Asst. Dr.

AAB College

email: xhavit.rexhaj@aab-edu.net

Abstrakt

Ky studim trajton teorinë e rendit natyror të përvetësimit të gjuhës amtare, e cila tregon se ekziston një rend i caktuar i përvetësimit të trajtave dhe të morfemave të ndryshme gramatikore të gjuhës amtare, por edhe të gjuhës së dytë / të huaj.

Gjuhët e mëdha botërore kanë studiuar renditjen e përvetësimit të morfemave dhe të trajtave gramatikore, ndërkaq deri tash nuk ka pasur një studim të kësaj natyre për gjuhën shqipe. Një studim i tillë do të ndihmonte për përmirësimin e përvetësimit të gjuhës amtare, për organizimin e kurrikulës së gjuhëve në shkolla dhe do të ndikonte për mësimin e gjuhës shqipe si gjuhë e huaj. Në hulumtim kanë marrë pjesë më se 100 hulumtues të rinj, të cilët kanë vëzhguar për dy javë më se 200 fëmijë të katër grupmoshave në spektrin prej 0-11 vjeçare. Vëzhgimi ka mbledhur material natyralist joeksperimental për të konstatuar ekzistimin e rendit natyror të përvetësimit të gjuhës shqipe si gjuhë amtare. Studimi ka konstatuar ekzistimin e një rendi të tillë në përputhje me teorinë e procedimit, e cila nënkupton përvetësimin gradual prej trajtave më të thjeshta kah ato më komplekse. Një gjetje e paplanifikuar e studimit ka qenë roli i dialektit dhe i të folmeve në procesin e përvetësimit të gjuhës

¹ dhe studentët Blerinda Hajdari, Leonora Ilazi, Bekim Jashari, Leotrim Ibrahim, Rita Bekqeli, Marigona Zejnullahu, Arbana Mazreku, Diellza Hyseni, Flaka Balidemaj, Agnesa Pllana, Albina Gllavica.

shqipe. Njëkohësisht, studimi nuk ka arritur ta dallojë dhe të përcaktojë më saktësisht rolin e shkollës dhe të mjedisit në procesin e përvetësimit të gjuhës shqipe.

Fjalë kyç: *rendi natyror, përvetësimi i gjuhës, morfemat gramatikore, dialekti.*

Hipoteza e rendit natyror të përvetësimit të gjuhës amtare është formuluar fillimisht nga Brown (Brown, 1973) i cili raportonte se tre fëmijë të vëzhguar gjatë një periudhe nëntëvjeçare, të cilët mësonin gjuhën angleze si gjuhë amtare, i përvetësonin disa morfema gramatikore ose fjalë funksionale më herët se të tjerat. Për shembull, morfema /*ing*/ e trajtës së vazhdueshme (si në "he is playing baseball") dhe shënjesi i shumësit /*s*/ ("*two dogs*") ishin ndër morfemat e para të përvetësuara, për dallim prej shënjesit të njëjësit /*s*/ (si në "*He lives in New York*") dhe shënjesin /*s*/ të pronësisë ("*John's hat*") që përvetësoheshin prej gjashtë muaj deri në një vit më vonë (Krashen, 2009). Disa studime, të cilat do të diskutohen në pjesën e teorisë, kanë krijuar një listë të renditjes kronologjike të moshës së fëmijës përkitazi me përvetësimin e morfemave, funksioneve e trajtave gramatikore e sintaksore.

Tabela 1: Lista e Krashen për renditjen e përvetësimit të gjuhës angleze si gjuhë e dytë.



Studimi është bazuar në shqyrtimin e literaturës për teorinë e rendit natyror dhe në një hulumtim empirik të kryer nga studentët e Kolegjit AAB. Teoria e rendit natyror është studiuar tashmë për gjuhë të tjera të mëdha, si: gjuha spanjolle, ruse dhe ajo gjermane, mirëpo është hera e parë që trajtohet për gjuhën shqipe.

Krahasuar me burimet e referuara në pjesën teorike, ky hulumtim ka shtrirje më të gjerë tematike, duke trajtuar rendin e përvetësimit dhe të formimit të pyetjeve, fjalive mohore, fjalive, përdorimin dhe përvetësimin e trajtave kohore, përdorimin e pjesëve të tjera të ligjëratës (mbiemrat, ndajfoljet, përemrat) e të tjera. Gjatë procesit të hulumtimit ka dalë nevoja për studimin edhe të raportit të gjuhës standarde me dialektin ose të folmet e mjediseve të ndryshme në Kosovë, pasi që këto kanë rezultuar të jenë element thelbësor i përvetësimit të gjuhës shqipe si gjuhë amtare.

Mosha e fëmijëve të vëzhguar paraqitet si variabël e pavarur, ndërsa si variabla të varura janë përdorur trajtat e ndryshme gramatikore, si: pyetjet, fjalitë mohore, formimi i fjalive, mbiemrat, ndajfoljet, e të tjera (rendi i epërm në tabelën në vijim), por edhe aspekte të ndryshme, si koha dhe proceset e përvetësimit (rendi fundor).

Tabela 2: Variablat e përdorura në hulumtimin empirik

AspektiMo sha	Pyetj et	Trajta mohor e	Kohët e foljev e	Formi mi i fjalive	Trajt a të tjera	Diale kti / e folmj a
1-2 vjeç						
3-4 vjeç						
5-7 vjeç						
8-11 vjeç						
Variablat e varura	Paraqitja e parë	Forma kalimta re	Imitim – gjeneralizim		Dallimet individua le Zhvillimi kognitiv	

Duke qenë i pari i këtij lloji dhe duke pasur parasysh se është zhvilluar nga studentët dhe nga një ekip me përgatitje të kufizuar në fushën e gjuhësisë së aplikuar, ky hulumtim i ka kufizimet e veta. Këto kufizime mund të tejkalohen në të ardhmen duke përdorur instrumente të standardizuara për vëzhgimin dhe matjen e përvetësimit të gjuhës, duke aplikuar metodë më të besueshme hulumtuuese, duke përfshirë numër më të madh të respondentëve dhe, sidomos, duke trajtuar më thellësisht grupmoshat e veçanta të fëmijëve.

Qëllimi kryesor ka qenë të hulumtohet renditja e përvetësimit të strukturave, të trajtave e të funksioneve të ndryshme morfologjike e sintaksore të gjuhës shqipe si gjuhë amtare të fëmijët e moshave të caktuara, ashtu siç manifestohet në komunikimin dhe ndërveprimin e tyre të përditshëm me mjedisin që i rrethon, dhe, sa herë që një gjë e tillë të ishte e realizueshme, duke krahasuar këtë rend të përvetësimit me atë të gjuhës angleze.

Objektivat: Qëllimi i mësipërm është arritur duke identifikuar paraqitjet fillestare të formave dhe të funksioneve gjuhësore në vijim: pyetjet, trajtat mohore, kohët e përdorura të foljeve, formimi i fjalive, e të tjera. Po ashtu, janë shikuar aspekte të ndryshme, si: proceset e përvetësimit të gjuhës (imitim – gjeneralizim), reflektimi i zhvillimit kognitiv në gjuhën e përdorur, të kuptuarit e konceptit të kohës dhe reflektimi i këtij të kuptuari në trajtat kohore të përdorura. Pos këtyre, është bërë vlerësimi i ndikimit të dialektit dhe i të folmeve në përvetësimin e gjuhës amtare dhe, në fund, aty - këtu është trajtuar edhe ndikimi i karakteristikave individuale të fëmijës në nivelin e komunikimit dhe formave të përdorura.

Pyetjet kërkimore

Hulumtimi i rendit natyror të përvetësimit të gjuhës shqipe si gjuhë amtare është bazuar në pyetjet kërkimore në vijim:

Cili është rendi i përvetësimit të trajtave dhe të funksioneve gramatikore e sintaksore gjatë përvetësimit të gjuhës shqipe si gjuhë amtare?

Cila është koha dhe dinamika e përvetësimit të trajtave të njëjta gramatikore në gjuhën shqipe e angleze?

Cili është ndikimi i dialektit / i të folmeve dhe relacioni i tyre me gjuhën standarde në procesin e përvetësimit të gjuhës shqipe si gjuhë amtare në Kosovë?

Cili është roli i shkollës në përdorimin e dialektit / standardit gjuhësor gjatë përvetësimit të gjuhës shqipe si gjuhë amtare?

Hipotezat

Jemi nisur nga hipoteza nul se nuk ekziston një rend i caktuar i përvetësimit të trajtave e të funksioneve gjuhësore në gjuhën shqipe si gjuhë amtare.

Rëndësia e këtij studimit konsiston në sa vijon:

- Me këtë hulumtim, gjuha shqipe hyn në radhën e gjuhëve që kanë filluar ta studiojnë rendin e natyrshëm të përvetësimit të gjuhës amtare;
- Rendi i identifikuar i përvetësimit të gjuhës shqipe i informon hartuesit e kurrikulës dhe të teksteve shkollore për një modalitet të mësimin të strukturave, të trajtave e të morfemave të ndryshme gramatikore të gjuhës shqipe si gjuhë amtare sipas një renditjeje të natyrshme;
- Materialet e mbledhura dhe të analizuar mund t'u shërbejnë si burime primare studiuesve të tjerë vendorë e ndërkombëtarë të interesuar për këtë fushë.

Më tutje, në këtë punim paraqiten disa teori dhe koncepte themelore që kanë shërbyer si bazë teorike për zhvillimin e hulumtimit dhe të analizës së gjetjeve në temën e hulumtuar. Pastaj jepet metodologjia e hulumtimit, e pasuar nga prezantimi i gjetjeve nga hulumtimi empirik dhe nga studimi i literaturës. Në fund jepen konkluzionet e hulumtimit, si dhe sugjerimet për kahet e thellimit eventual në këtë fushë, duke përfshirë Shqipërinë dhe rajone të Maqedonisë ku flitet gjuha shqipe si gjuhë amtare.

Korniza teorike

Hipoteza e rendit natyror: Pas Brown (që u diskutua shkurt në hyrje të këtij punimi), ishin de Villiers and de Villiers (1978) që i konfirmuan rezultatet longitudinale të Brown me një hulumtim që bënte një matje të shkallës së përvetësimit të gjuhës në një kohë të caktuar. Ata konstatuan se morfemat, për të cilat Brown kishte konstatuar se mësohen më herët, janë edhe strukturat më të lehta për fëmijët në testet e organizuara për këtë qëllim. Domethënë, sa më të lehta për fëmijët, më herët ishin përvetësuar dhe anasjelltas, ishte konstatuar një raport i drejtë i shkallës së përvetësimit dhe i vështirësisë së morfemave për përvetësim (Krashen, 2009, p. 12).

Rrjedhimisht, është e natyrshme të pritet se ekziston një rend sipas të cilit fëmijët përvetësojnë strukturat, trajtat, morfemat dhe funksionet e ndryshme gjuhësore në gjuhën amtare. Njëkohësisht, studiues të ndryshëm (Krashen, 2009; Dulay & Burt, 1974, 1975; Kessler, 1977) kanë studiuar rendin e përvetësimit të gjuhës angleze si gjuhë e dytë, duke gjetur ngjashmëri të shumta për nga rendi i përvetësimit në mes të gjuhës amtare, që është objekt i këtij studimi, dhe gjuhës së dytë.

Ata thonë se megjithëse ka dallime në përvetësimin e një gjuhe (në këtë rast gjuha angleze) si gjuhë e dytë, edhe këtu mund të vërehet një rend i natyrshëm i përvetësimit të gjuhës së dytë. Studiues të tjerë e kanë kontestuar këtë tezë për rendin e natyrshëm të përvetësimit të gjuhës së dytë, duke theksuar se është vështirë të krahasohet përvetësimi i gjuhës amtare me gjuhën e dytë thjesht për shkak se zakonisht e dyta vjen pas një kohe të konsiderueshme - me përjashtim të fëmijëve dygjuhësorë. Colin Fry (2018), lidhur me kritikën ndaj teorisë së Krashenit për rendin natyror, thotë se "*Larsen - Freeman dhe Long në kritikën e tyre shtojnë se nuk ofrohen shpjegime për rendin e*

morfemave". Në përgjithësi, vërejtjet kryesore ndaj hipotezës së rendit natyror mbështeten në faktin se morfemat kanë të bëjnë me prodhimin e artikulimin e gjuhës, ndërsa teoria e Krashen lidhet me kompetencën dhe njohjen e gjuhës. Megjithëkëtë, për ekzistimin e rendit natyror për përvetësimin e gjuhës amtare duket se ekziston pajtueshmëri e përgjithshme e studiuesve dhe nuk paraqitet si pengesë që të shërbejë si kornizë teorike e studimit tonë.

Vështirësia e të nxënit: E lidhur me hipotezën e rendit natyror të të nxënit të gjuhës është edhe koncepti i vështirësisë së të nxënit të gjuhës (ang. learning difficulty). DeKeyser (2003) dallon vështirësinë objektive dhe atë subjektive. Ai thotë se "vështirësia objektive ka të bëjë me vështirësitë inherente të trajtave të ndryshme gramatikore". Disa trajta gramatikore, në bazë të teorive të ndryshme gramatikore, do të jenë më të lehta për t'u nxënë, ndërsa të tjerat më të vështira. Për ilustrim, është e logjikshme të pritet që trajtat e përbëra gramatikore me folje ndihmëse do të jenë më të rënda për t'u përvetësuar se sa trajtat e thjeshta të së tashmes. Në anën tjetër, vështirësia subjektive ka të bëjë me vështirësitë aktuale që përjetojnë nxënësit e gjuhës. Për ne, më i rëndësishëm është koncepti i vështirësisë objektive që del më i afërt me hipotezën e rendit natyror të të nxënit.

Teoria e procedimit gradual: Një teori tjetër relevante është teoria e procedimit (Ang. processability theory) e cila, sipas Pienemann (2005), "*supozon se mjetet e procesimit do të përvetësohen në një renditje të aktualizimit në procesin e prodhimit*" (f.13). Megjithëse teoria e procedimit është teori tipike e prodhimit gjuhësor e jo e përvetësimit të gjuhës, ajo gjen aplikim edhe në procesin e përvetësimit si të gjuhës amtare, ashtu dhe të gjuhës së dytë. Rrjedhimisht, përvetësimi gradual i gjuhës sipas një renditjeje të caktuar aplikohet edhe në rastin tonë të përvetësimit të gjuhës shqipe si gjuhë amtare: prej formave më të lehta kah format më komplekse ose prej fjalëve

(përmes sintagmave e fjalive) deri te fjalitë e përbëra. Lidhur me këtë, Pienemann (2008) thotë se “*versioni origjinal i teorisë së procedimit ngrihet mbi supozimin se zhvillimi i gjuhës është i kufizuar nga procedimi gradual. Kjo ndikon si në zhvillimin e gjuhës amtare, ashtu dhe në zhvillimin e gjuhës së dytë (megjithëse në mënyra krejtësisht të ndryshme). Kjo ndikon edhe në variantin e gjuhës së ndërmjetme (interlanguage variation) dhe në transferimin në gjuhën e parë*” (f.13). Domethënë, procedimi gradual, përvetësimi i strukturave gjuhësore sipas një renditjeje hierarkike, e ne do të shtonim edhe sipas një rendi natyror, aplikohet edhe në rastin e përvetësimit të gjuhës amtare. Kjo do të thotë se dështimi për të zotëruar një procedurë të rendit të ulët (për shembull hapi 3 në skemën më poshtë) do të pamundësojë përvetësimin e një procedure të rendi më të lartë dhe, rrjedhimisht, nxënësi nuk do të jetë në gjendje të përvetësojë trajtat gramatikore që varen nga kjo procedurë (Ellis, 2009, p. 146).

Kjo hierarki e përvetësimit – procedimit, sipas Pienemann (marrë nga Rod Ellis, f. 146), është si në vijim:

1. fjala / lema;
2. procedura kategoriale (kategoria leksikore);
3. procedura sintagmatike (fjala kryesore);
4. procedura e kryefjalës (SVO) dhe rregulli i rendit të fjalëve në fjali;
5. skema / fjalia e përbërë.

Më tutje, në këtë punim, do të jemi dëshmitarë të renditjes së përvetësimit, ku më shumë e ku më pak, sipas këtyre fazave të procedimit:

Tipat e gjuhës dhe rendi natyror: Studimet e para në rendin natyror të përvetësimit të gjuhës amtare janë bërë për gjuhën angleze. Për shkak të natyrës analitike të gjuhës angleze, rendi i konstatuar i gjuhës angleze në njëfarë mënyrë ka bërë që rendi natyror të shihet si një rend i thjeshtë dhe i matshëm i

përvetësimit të morfemave të ndryshme. Domethënë, Brown ka konstatuar se së pari përvetësohet mbaresa e së tashmes së vazhduar të anglishtes *-ing*. Pasi që *-ing* ka një formë të pandryshuar në të gjitha aspektet e trajtat e foljes së cilës i përngjitet për të formuar aspektin e vazhdimësisë, është konstatuar se *-ing* është e para. Ngjashëm me këtë janë trajtuar edhe trajtat e tjera si 's e vetës së tretë, 's e pronësisë, -s e shumësit të rregullt, *-ed* e kohës së kryer, e të tjera, të cilat sikurse *-ing* kanë formë të pandryshuar në të gjitha vetat, kohët ose aspektet respektivisht. Kjo ka bërë që të thjeshtësohet fenomeni i rendit natyror të përvetësimit të gjuhës duke menduar se do të jetë njësoj lehtë që të studiohen edhe gjuhët e tjera, përfshirë edhe ato sintetike, siç është gjuha shqipe.

Mirëpo, qysh në fazat e përgatitore të këtij hulumtimit, u bë e qartë se referimi në aspektet e përvetësimit të gjuhës angleze nuk do të përbënte bazë të përshtatshme edhe për trajtimin e përvetësimit të gjuhës shqipe. Kjo, sepse ndërlikueshmëria e sistemit të mbaresave në gjuhën shqipe e bën studimin e rendit natyror të përvetësimit të gjuhës shumë më të ndërlikuar se që është rasti me gjuhën angleze. Shënjimi i numrit, i vetës dhe i trajtës (së shquar) në të njëjtën fjalë (p.sh.: *të miat*) është më e ndërlikuar se sa, për shembull, përcjellja e paraqitjes së parë të përdorimit të rregullt të një mbiemri përkatës pronor në gjuhën angleze (*mine*), ku aspektet e ndryshme shprehen nëpërmjet mekanizmit analitik. Për ilustrim, numri shumësi i pronës në *mine: they* ose *these are mine*.

Kjo për arsye se, për nga vetë natyra e tyre, gjuha shqipe dhe gjuha angleze dallojnë dukshëm. Që të dyja, si gjuha angleze dhe ajo shqipe, aplikojnë mjetet analitike dhe sintetike për shprehjen e aspekteve të ndryshme gramatikore. Mirëpo, përkundër pranisë së të dyja qasjeve në këto dy gjuhë, prapëseprapë: te gjuha shqipe dominon elementi sintetik, ndërkaq te gjuha angleze dominon elementi analitik.

Autorë të shumë vendorë dhe ndërkombëtarë (Demiraj, 1988a, 1988b; Pedersen, 1894; Meyer, 1883; Ismajli, 2003; Bokshi, 1980) kanë studiuar dhe konstatuar praninë e të dyja elementeve në gjuhën shqipe; ata flasin edhe për një prani dominuese të mekanizmave sintetikë, krahas një pranie më të vogël të atyre analitikë. Në Gramatikën e Gjuhës Shqipe të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë mësojmë se “*Format gramatikore të gjuhës shqipe janë sintetike dhe analitike*” (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2002). Më tutje, në mënyrë përshkruese paraqiten format sintetike dhe ato analitike, pa treguar se cili prej këtyre tipave është më shumë i pranishëm në gjuhën shqipe. Ndër format sintetike përshkruhen mbaresat e ndryshme (*mali-i, hap-a, hap-ëm, mir-i*) që u shtohen pjesëve të ndryshueshme të ligjëratës, prapashtesat temëformuese (*shokë, male, burra* etj) dhe ndërrimet fonetike. Ndër format analitike paraqiten format që krijohen me foljet ndihmëse (*kam e jam*), me pjesëzat formante (*të punoja, pa punuar, për të punuar* etj.) dhe me përdorimin e nyjave (*i nxënësit, e nxënësit*) e të tjera. Shaban Demiraj (1988b) tregon se gjatë zhvillimit historik gjuha shqipe ka zhvilluar elemente sintetike-analitike, ndërsa gjuha angleze ato analitike – sintetike. Në Gramatikën e tij historike, por edhe në studime të tjera, ai thekson se:

Gjallërimi gjithnjë e më i madh i fjalëve shërbyese disa prej të cilave ... janë shndërruar në formante, ka bërë që struktura gramatikore e gjuhëve të shndërrohet nga një tip sintetik, ... në një tip sintetik -analitik (si për shembull gjuha latine, greke, shqipe, gjuhët sllave etj.), ose analitik-sintetik (si për shembull në gjuhën angleze, gjuhët romane perëndimore e të tjera).

Pos kësaj, Demiraj tregon se elementet dominuese të tipit sintetik vërehen tek trajtat që shprehin mënyrën, lakimin e

emrave, zgjedhimin e foljeve, përdorimin e parafjalëve e të fjalëve të tjera strukturore, formën e shquarsisë, rendin (më të ngurtësuar ose më të lirë) të fjalëve në fjali e të tjera (1988a). Bokshi (1980) në anën tjetër, konfirmon natyrën dominuese sintetike të gjuhës shqipe duke studiuar aspektet morfologjike dhe sintagmatike të fleksionit nominal.

Përderisa gjuha shqipe karakterizohet nga dominimi i elementit sintetik, gjuha angleze dominohet nga elementi analitik:

Shumica e këtyre kategorive gramatikore, të cilat mund të formohen në mënyrë sintetike, mund të shprehen edhe me mjete analitike (si për shembull krahasimi i mbiemrave, ose rasa gjinore); të tjerat gjithmonë formohen në mënyrë perifrastike, nëpërmjet përdorimit të fjalëve funksionale (si për shembull shumë kohë të foljeve ose aspekti), ose nuk shprehen më fare (si për shembull gjinia gramatikore). Për shkak të numrit të kufizuar të morfemave mbaresore, gjuha moderne angleze konsiderohet një gjuhë analitike. (Dorgeloh, 2009)

Roli i dialektit: Një aspekt i rëndësishëm është prania dhe roli i dialektit dhe i të folmeve gjatë përvetësimit të gjuhës shqipe si gjuhë amtare dhe, në po këtë kontekst, roli i familjes dhe i shkollës në shkallën e përdorimit të trajtave dialektore nga fëmijët. *“Variantet rajonale duket se realizohen kryesisht në fonologji. Thënë ndryshe, ne zakonisht i dallojmë dialektet e ndryshme nga shqiptimi dhe theksi i tyre para se të vërejmë se edhe fjalori i tyre dallon. Variacionet gramatikore janë më pak të dalluara dhe gjithsesi bien në sy më pak* (Randolph Quirk, 1992). Studimi ynë ka siguruar dëshmi të konsiderueshme për variacione gramatikore (p.sh.: *shkojna, shkojmi, shkojim, shkojmë*) që pjesërisht shkon ndesh me konstatimin e mësipërm. Po aty (p. 19) autorët

vërejnë “një polarizim të rëndësishëm në mes të së folmes së personave të paarsimuar dhe atyre të arsimuar, ashtu që të parët në të shumtën e rasteve identifikohen me një dialekt rajonal, ndërsa të dytët i ikin të folmes dialektore duke përdorur një formë përtej kufijve dialektor”. Siç do të shihet më vonë, shkollimi dhe niveli i arsimit të mësimdhënësve nuk duket të ndikojë shumë në gjuhën e përdorur nga fëmijët pas disa viteve të shkollimit.

Rexhep Ismajli (2003), duke folur për raportin në mes të gjuhës popullore dhe asaj standarde u referohet atyre si varietete ‘organike’ e ‘standarde’ dhe thekson se “si varietet ‘organik’ shihet varieteti amtar, i pari, ai që nxitet përmes imitimit, varietet në aspektin shoqëror homogjen, i mbyllur me fizionomi të caktuar qytetëruese; atë e flet një krahinë, një rreth, pra është një dialekt, një e folme”. Më tutje, autori thekson se standardi lidhet kryesisht me gjuhën e shkruar dhe se “Standardi është autonom, i normuar, polivalent ... nga aspekti psikologjik jospontan, i kontrolluar, i nxënë përmes shkollimit”. Këtu hasim në disa elemente me interes për studimin tonë, por do t’i theksojmë dy: (i) varieteti organik përvetësohet nëpërmjet imitimit dhe (ii) standardi mësohet nëpërmjet shkollimit. Këto dy teza janë testuar nëpërmjet hulumtimit tonë për të parë rolin e familjes dhe të rrethit, në njëërën anë, dhe të shkollimit në anën tjetër. Në vazhdim autori nxjerr edhe një tezë tjetër me interes përkitazi me rolin e trajtimit të gjuhës popullore dhe të asaj standarde në mësimdhënie. Ismajli (p. 170) mendon se gjuha popullore mund të shërbejë për zhvillimin e aftësisë së shprehjes me gojë dhe të komunikimit, ndërsa standardi gjuhësor për t’ua shpjeguar normën gjuhësore nxënësve, mirëpo duke insistuar se të dyja këto forma duhet të aplikohen të integruara në mësimdhënie. Hulumtimi i kryer me studentët e gjuhës angleze e ka trajtuar edhe këtë segment të

mësimdhënies duke përcjellë artikulimin verbal të fëmijëve të katër grupmoshave.

Format kalimtare: Një dukuri e rëndësishme për përvetësimin e gjuhës amtare është koncepti i quajtur i formave kalimtare gjatë procesit të përvetësimit të gjuhës. Në këtë kontekst, Stiven Krashen (2009) flet për dallimin në mes të trajtave të përvetësuara plotësisht kur fëmijët kanë mësuar dhe artikulojnë morfema, trajta e struktura plotësisht të formuara. Megjithatë, disa studime pohojnë se para se të arrihet në trajtat e plota dhe të artikuluara drejt, paraqiten disa forma kalimtare ose zhvillimore që nënkuptojnë gabime në shqiptim dhe në përdorim të trajtave (p. 12). Për shembull: *mami më /fa/* (në vend e më /tha/), *Dea nuk don me ku* (përdorimi i vetës së tretë njëjës dhe shqiptimi i foljes 'shkuar'); *butujose* (bukuroshe), *tutël* (kukull) e të tjera. Këto forma kalimtare janë shumë me interes, pasi që ndonjëherë në vend se të shndërrohen në trajta adekuate, me kalimin e kohës ngurtësohen dhe mbesin në përdorim si trajta finale nga fëmija dhe i riu.

Formimi i pyetjeve : Njësoj sikurse me kategoritë e tjera gramatikore, edhe formimi i trajtës pyetëse duket se e ndjek një logjikë të rendit natyror të përvetësimit. Në kontestin e diskutimit të fjalëve pyetëse, Luiz Blum (1991) thotë se "Është konstatuar një rregullsi në mënyrën se si fëmijët mësojnë të formojnë pyetje në gjuhën angleze. Në këtë kontekst, mund të flitet për një rend të parashikueshëm të paraqitjes së fjalëve pyetëse. Zakonisht '*What*' (*Çfarë*) është fjala e parë pyetëse që përdoret nga fëmijët. Zakonisht ajo përvetësohet si pjesë e një tërësie (Ang. *Whassis*; shqip 'kaokjo?') dhe mund të kalojë një kohë para se fëmija ta kuptojë se forma e artikulluar ka versione të ndryshme si në *Çka është kjo?* ose *Çka janë këto?* (Patsy Lightbown, 2013, p. 11). Këto gjetje konfirmohen edhe në një studim të mëhershëm nga Bloom e të tjerët ku thuhet se "Fëmijët në këtë studim kanë mësuar të bëjnë pyetje me fjalët pyetëse

/wh/ në të njëjtën renditje zhvillimore ashtu që *çfarë, ku* dhe *kush* janë mësuar para fjalëve *pse, si* dhe *kur* (Lois Bloom, 1982). Në studimin tonë jemi orvatur të konstatojmë se cilat fjalë pyetëse janë paraqitur më herët dhe cila është renditja e tyre.

Formimi i trajtës mohore: Në librin “Si mësohen gjuhët” nga Patsy Lightbown e Nina Spada (2013) thuhet se sikurse në rastin e pyetjeve, edhe shprehja e kundërshtimit apo formimi i fjalive mohore kërkon një proces të të nxënit që lëviz prej formave të thjeshta e deri te fjalitë më komplekse mohore (p. 9). Më tutje, po aty, tregohet për rendin e formimit të trajtës mohore në gjuhën angleze prej disa etapash duke filluar prej gjesteve kundërshtuese e përdorimit të fjalës ‘no’ (shqip *jo*), e deri te fjalitë më komplekse mohore (p.sh.: sintagmat pyetëse në etapën e gjashtë). Njësoj si në gjuhën angleze, studime të tjera kanë vërtetuar ekzistimin e një rendi të caktuar të trajtave mohore edhe në gjuhët e tjera (Wode, 1981). Hulumtimi ynë ka trajtuar po këtë dukuri të formimit gradual të trajtave mohore.

Të nxënit e gjuhës përmes imitimit dhe gjeneralizimit: Imitimi dhe gjeneralizimi janë dy procese të rëndësishme të përvetësimit të gjuhës amtare. Lidhur me imitimin, Fraser et al. (1963) theksojnë se “imitimi i konstrukteve gramatikore nga fëmijët rregullisht e tejkalon të kuptuarit e tyre, i cili, në anën tjetër, e tejkalon të folurit e lirë të fëmijëve”. Domethënë, nëpërmjet imitimit, fëmijët shprehin gjithnjë më shumë se që kuptojnë ose flasin në të folurit e qëllimshëm. Pra, ata mund të përsërisin struktura të dëguara në mjedisin e vet, por nuk i dallojnë, për shembull, fotot e njëjta kur u tregohen atyre (p. 121). Gjeneralizimi, në anën tjetër, është një proces i të nxënit që krijon ose ndërton konstrukte gjuhësore duke u nisur nga materiali me të cilin vijmë në kontakt ose e dëgjojmë në jetën e përditshme. Lidhur me gjeneralizimin, Adele Goldberg thotë se ka të bëjë me pyetjen:

Si i përvetësojnë nxënësit e gjuhës gjeneralizimet në një mënyrë që ata mund të prodhojnë numër të pakufizuar të artikulimeve duke u bazuar në një sasi të kufizuar të materialit të dëgjuar? Përse janë gjuhët kështu si janë? ... Këto qasje theksojnë se dija e folësve konsiston në një tërësi sistematike sajesh duale që përbëjnë formën dhe funksionin e të cilat mësohen duke u nisur nga gjuha që e dëgjojnë përreth tyre. (Goldberg, 2006).

Hulumtimi ynë ka provuar të fokusohet në momentet e kalimit të përvetësimit të gjuhës nga proceset e imitimit në krijimin e konstrukteve gjuhësore nëpërmjet gjeneralizimit.

Metodologjia

Gjithsej 97 studentë kanë kryer hulumtimin me rreth 200 fëmijë duke vëzhguar mënyrën e komunikimit të tyre (verbal dhe joverbal) me njerëzit në mjedisin e tyre. Fëmijët e vëzhguar ishin ndarë në katër grupmosha: 1-2, 3-4, 5-7 dhe 7-11 vjeç. Kjo ndarje është bazuar në fazat e rëndësishme të zhvillimit kognitiv të fëmijës, të cilat korrespondojnë edhe me fazat e zhvillimit kognitiv të identifikuar nga Piazhë dhe, njëkohësisht, ngërthejnë edhe ndryshime të rëndësishme në cilësinë e komunikimit të fëmijëve me mjedisin. Mosha një- dhe dyvjeçare paraqet format e para të komunikimit të mirëfilltë me mjedisin, mosha 3-4 vjeçare sjell ndryshime të rëndësishme në zhvillimin e imagjinatës dhe të komunikimit verbal, mosha 5-7 vjeçare lidhet me përvetësimin e e shkathtësive të leximit e të shkrimit dhe me socializimin e ndërveprimin më aktiv me fëmijë të tjerë, qoftë në çerdhe ose në institucione parashkollore; faza e fundit (para-operacionale) pasqyron një fazë më komplekse të zhvillimit dhe të përdorimit më intensiv të komunikimit verbal e të shkruar. Këto katër faza përputhen pjesërisht me fazat e zhvillimit kognitiv të Piazhës (Piaget,

1959), me përjashtim të fazës operacionale të moshës 11-16 vjeçare, e cila nuk është përfshirë në këtë hulumtim. Kjo fazë është lënë anash me qëllim pasi që gjuhësisht nuk sjell ndonjë zhvillim të rëndësishëm, por edhe sepse i tejkalonte aftësitë hulumtuese të ekipit tonë (studentë të vitit të parë baçelor) të gjuhës angleze.

Hulumtimi është zhvilluar në formë të mbledhjes së materialeve natyraliste gjuhësore (Creswell, 2012) që kanë dalë nga përvojat e komunikimit të fëmijëve të vëzhguar me mjedisin e vet. Vëzhgimi ka qenë i tipit natyralist joeksperimental (Frey, 1999) dhe është përqendruar në: formimin e pyetjeve, formimin e trajtave mohore, përdorimin e kohëve të foljeve, formimin e fjalive dhe përdorimin e trajtave të tjera (mbiemra, përemra dhe ndajfolje). Puna në vëzhgim ishte ndarë në mënyrë të barabartë ndërmjet hulumtuesve: *secili student do të vëzhgonte së paku një deri dy fëmijë në një ose dy grupmosha të ndryshme dhe në së paku dy aspekte (pyetjet, ose trajtat mohore, ose foljet e të tjera) gjatë një periudhe prej dy javësh*. Fëmijët janë vëzhguar (pas miratimit të prindërve) në familjen e vëzhguesve, në fqinjësi, ose te të afërmit. Sa herë që ka qenë e mundur dhe me leje të posaçme, studentët kanë vëzhguar edhe fëmijët në institucione parashkollore². Nga vëzhguesit kërkohet të mblidhnin shënime për të dhënat natyraliste dhe të bënin një reflektim të shkurtër të gjetjeve më interesante (në përputhje me protokollin e vëzhgimit dhe me instruksionet me shkrim e me gojë).

Për të ofruar dëshmi plotësuese, ata duhej të bënin audio dhe / ose video-incizime, ose të mbanin shënime për format e përdorura nga fëmijët. Së paku gjysma e studentëve vëzhgues

² Duam të falënderojmë familjet dhe institucionet parashkollore që kanë lejuar dhe mundësuar zhvillimin e këtij hulumtimi.

kishin hartuar edhe pyetësorë të thjeshtë (duke përdorur udhëzimet e dhëna në protokollin e vëzhgimit).

Pos regjistrimit të materialeve, hulumtuesit duhej të plotësonin një tabelë me pesë shtylla (shih Protokollin në Shtojca 1), nga një për secilin aspekt të vëzhguar: pyetjet, trajtat mohore, kohët e foljeve, formimi i fjalive dhe trajtat e tjera. Hulumtuesit vëzhgonin dhe plotësonin tabelat në bazë të instruksioneve të dhëna me shkrim dhe në seancat përgatitore e konsultuese lidhur me hulumtimin. Të dhënat për aspektin e gjashtë për dialektin dhe të folmet janë përpunuar dhe analizuar pasi që ishte mbledhur materiali.

Të dhënat e mbledhura natyraliste janë përpunuar, koduar dhe klasifikuar sipas moshave / aspekteve të vëzhguara nga trembëdhjetë studentë, të cilët kanë qenë më aktivë gjatë mbledhjes së të dhënave. Për shembull, një student nga ky grup e ka përpunuar tërë materialin e mbledhur për formimin e pyetjeve për dy grupmosha. Kësisoj, secili aspekt (p.sh.: formimi i pyetjeve) është përpunuar nga së paku dy studentë, secili për moshat përkatëse. Pos përpunimit mekanik të të dhënave, ata kanë bërë analizën dhe kanë nxjerrë reflektime preliminare nga të dhënat e përpunuara.

Vështirësitë më të mëdha hulumtuesit i hasën gjatë vëzhgimit të fëmijëve të moshave më të vogla, të cilët heshtnin sa herë që vërenin se po vëzhgoheshin ose kur aktivizohej telefoni / kamera / minikorderi për incizim³.

³ Në anën tjetër, hulumtimit i mungonte një procedurë - pyetësor më i standardizuar për të gjitha grupmoshat.

Prezantimi dhe diskutimi i rezultateve

Në vijim paraqiten dhe diskutohen rezultatet e hulumtimit të rendit natyror të përvetësimit të gjuhës shqipe si gjuhë amtare, të strukturuar sipas aspekteve (variablove) kryesore të trajtuara në instrumentin e hulumtimit dhe grupmoshat e fëmijëve:

Aspektet e trajtuara (variablat e varura):

- Formimi i pyetjeve;
- Formimi i fjalive mohore;
- Formimi i fjalive;
- Përdorimi i trajtave kohore;
- Trajtat e ndryshme të përdorura (mbiemrat, ndajfoljet, përemrat);
- Ndikimi i dialektit dhe i të folmeve (është vendosur më vonë).

Grupmoshat⁴ (variablat e pavarura):

- 1-2 vjeçare;
- 3-4 vjeçare;
- 5-7 vjeçare;
- 8-11 vjeçare.

Aspekti 1: Pyetjet

Mosha 1-2 vjeçare:

Në këtë moshë, sidomos gjatë vitit të parë, hasim pyetje të thjeshta telegrafike të formuara me pjesëza ('a') ose me fjalë pyetëse ('ku' ose më rrallë 'pse'), por të cilat shprehin kuptim të plotë. Pyetjet janë të mangëta nga aspekti sintaksor duke lënë

⁴ Grupmoshat janë përcaktuar edhe duke u bazuar në modelin e Piaget për fazat e zhvillimit kognitiv të fëmijës.

anash elementet dytësore të fjalisë dhe duke u bazuar në fjalë strukturore, kallëzues, e më shpesh dhe kryefjalë.

- Shembuj: *A? "Ku beba?" / Ku mama? Ku papa? Ku babi?*

Në këtë fazë më shpesh hasen kërkesa të ndryshme sesa pyetje të mirëfillta. Kërkesat shprehen me eksklamacione e me pasthirrma. Në këtë fazë rol shumë me rëndësi luajnë gjestikulacionet dhe shprehjet joverbale që më shpesh shprehin emocione dhe insistim. Kërkesat shprehen kryesisht me nga një fjalë (emër) dhe ndonjëherë me një emër dhe një folje (*ama ujë*). Intonacioni paraqitet si pjesë e rëndësishme e kuptimit të 'fjalisë' në këtë fazë.

Mamaa! Mil! Opa!? *Amaaa! Totaaaa* (kërkon tortë); *Pshe? Amaaa! A? Pet a* (prap a?) "*aaaaa qafi*" duke mbajtur duart në formë të përqaqimit. '*a?*' '*e?*' '*ë?*' '*He*'; *Ama ujë; Ama top; Ama mu; Mami jep* (me jep); *Ama luge!*

Në disa raste, kuptimi i pyetjes del vetëm nga intonacioni për mungesë të treguesve të tjerë të pyetjes:

- *Mami vi une?* (A mund te vij unë?).

Në vitin e dytë të jetës paraqiten elementet e pyetjeve më komplekse, si:

- *A kojna te Andi?* (A do të shkojmë te Andi?); "*Qa ban ti n'kol?*" , "*A e din qa oqt*" "*A pim bjen lojna*", "*A nuk ka televigjoli ljet a*" (A nuk ka televizori rrjet – me siguri e mësuar me imitim). "*Ku opa te Gani?*".

Mosha 3-4 vjeçare

Në këtë moshë bëhen pyetje më komplekse, duke përfshirë pjesëzën 'a' dhe të gjitha fjalët pyetëse, përfshirë fjalët *pse, kush, kur*, dhe pyetje me fjalët *çka, sa* e të tjera.

- Shembuj: *Pse? Kush? Ku?*

Për sa pot vyjn lojat? (Për cka po të duhen lodrat?)

A pot vyen sikjo? (A po të duhet kjo?)

A po i don dyat? (A po i do të dyja?)

Ska po skrun? (Çka po shkruan?) *Kul ka me alë babi?* (Kur ka me ardhë babi?)

Sa mke ble? (Cka më ke ble?)

A fej me ty shot? (A të flej me ty sot?)

Megjithatë, edhe në këtë moshë, nuk ka përfunduar procesi i formimit të pyetjeve të sakta më komplekse nga aspekti sintaksor. Domethënë, pyetjet bëhen shumë më komplekse, më të plota, por shpesh u mungon saktësia sintaksore dhe shqiptimi i drejtë i tingujve. Edhe në këtë fazë rol me rëndësi luajnë gjestikulacionet, mimika dhe shenjat e tjera joverbale.

Në këtë fazë, pyetjet e fëmijëve tregojnë se ata ende nuk e dallojnë mirë konceptin e kohës:

- *Mam a shkona edhe na qatje?* (Sheh në TV një aheng që ka ndodhur muaj më parë).

Mosha 5-7 vjeçare

Kjo është moshë e çerdhes dhe e shkollës, gjë e cila shprehet si në përmbajtje, ashtu dhe në forma më komplekse të pyetjeve. Në këtë fazë pyetjet kryesisht formohen duke përdorur pjesëzën pyetëse 'A' dhe përemrat lidhorë 'kush' 'çka' 'pse'.

- Shembuj: *A po i bajna detyrat? A guxoj mi ble dy loja? Cka je tu shkru ti? Pse pom bon shumë pyetje? A ma jep pak telefonin? A ma lexon prallen ti sot? A skom me shku nesor ne shkolle a? A munesh me ma ndreq qit lojë? Kush ka me ardhë nesor? E ti kush je? Qysh e ki emrin? Kush të pëlqen ty ma shumë?*

Sa osht ora? Kur ja fillon msimi? Shka kemi sot per dreke? (dialekti i Gjakovës, po ashtu: *pse spe rrin ti te na, a kemi me shku te halla mi pa*).

Në këtë fazë paraqiten ende gabimet në shqiptim për shkak të moshës së re. Mirëpo, ajo që është me rëndësi është se hasim më shpesh në format dialektore – kryesisht në vokabular. Domethënë vitet e çerdhes dhe klasat e para të shkollës nuk

reflektohen shumë në gjuhën e folur dhe në formimin e pyetjeve nga fëmijët.

Kjo fazë paraqet edhe të kuptuarit më kompleks të konceptit të kohës. Fëmijët fillojnë të vetëdijësohen më shumë për kohën e ardhme e të shkuar, të shprehur nëpërmjet pyetjeve:

- *Kur është mas pushimit? A keni me ardh nesër?*

Mosha 7-11 vjeçare

Tashmë fëmijët formojnë pyetje më komplekse dhe më të sakta nga aspekti gramatikor e sintaksor. Këtu formohen fjali të plota pyetëse me të gjitha pjesët e fjalisë, me përemra pyetës, me pjesëzën 'A' me përemra vetorë, me kundrinorë e të tjera. Po ashtu, në këtë moshë hasim pyetje të formuara në kohën e tashme dhe të kryer, të cilat përdoren në mënyrë të drejtë. Në këtë moshë fillon të paraqitet edhe përemri pyetës 'Cili / Cila' me siguri si trajtë e standardit gjuhësor e përvetësuar në shkollë. Është me interes të theksohet se vetëm në këtë fazë vërehet ndikimi i shkollimit në përdorimin e standardit gjuhësor edhe në formimin e pyetjeve, përfshirë dhe pyetjet që shprehin kërkesa të sjellshme (për shembull: *A ban me ma qu ni foto të bebes?*). Megjithatë, ruhen edhe format dialektore, por me frekuencë më të vogël:

Kur është programi? A jeni ju në fakulltet? Qka studioni? Cila ngjyre e keni qef? Qka je tu thanë? Qysh po kalon fakulltet?

A keni me nejt? A kini me shku najkun per vikend? A ban me ma qu ni foto tbebes? Kush a qajo qika nfoto? Pse pom bertet? Qka tha mami me ba?

Aspekti: Trajta mohore – fjalitë mohore

Mosha 1-2 vjeçare

Shprehja e mohimit, kundërshtimit, protestës në këtë fazë është shumë ekspresive dhe ngërthen elemente të pakta verbale dhe

elemente shumë të fuqishme joverbale dhe me ngarkesa emocionale. Kjo sidomos kur kanë të bëjnë me ushqimin, prindërit, konkurrencën, refuzimin e njerëzve të panjohur etj. Format kryesore verbale janë: 'jooo', 'ë-ë', 'jemiii' të përcjella kryesisht me mimikë e gjestikulacione të fuqishme në shenjë mohimi e kundërshtimi. Edhe në këtë fazë paraqiten mbiemrat që shprehin pëlqim ose mospëlqim (*keq – milë*); shpesh trajta mohore formohet duke kombinuar foljen me fjalën mohuese *jo* në vend të pjesëzës *nuk* (*Jo du - s'du*) ose duke dhënë trajtën pohore për shkak të pamundësisë së shqiptimit të tingullit të caktuar (/s/), për shembull: *ta jap – duke menduar s'ta jap*. Në këto raste kuptimi del kryesisht nga mimika ose gjestikulacionet e pasura në këtë moshë. Shembuj të tjerë për ilustrim të përgjithësimeve të mësipërme:

- *Jo*, "jo jo, ë-ë (më shpesh) me mimikë mohuese te fytyrës, *Ma-maaa, jemiiii, Joooo, MAMI i milë, BABI i milë, ma / mo* (për "mos"), a-a, *Jo, sssdu; Se jo se du; Jo se keq.*
- lëviz kokën në formë mohimi, lëvizje dëbuese të trupit, mimikë agresive e fytyrës, largohet me të gjithë trupin në shenjë mohimi.

Mosha 3-4 vjeçare

Në këtë moshë fëmijët tashmë formojnë fjali të shkurta mohore me paraqitje të pjesës mohuese *nuk* (edhe forma e shkurtuar 's' në kombinim me folje për shembull 'sdu'), *jo* ose *hiq*. Mohimi vazhdon të jetë i ngarkuar emocionalisht dhe të shprehet me forma ekspresive shprehëse të trupit. Fjalitë janë me elemente telegrafike, por shumë më plota se në moshën 1-2 vjeçare, duke shprehur qëndrime dhe mendime të plota mohuese, shpeshherë duke përfshirë edhe arsyetime të qëndrimit. Shembuj: *jo nuk du, kurgjo hiq sdu, hiq sdu jom idhnu skom ty moter mo, du me shku n'çerdhe edhe n'fakulltet, sdu me shku n'klas te pare hiq, Joooo, une hiq spo don.*

Shpesh fjalitë mohore ndërtohen mbi krahasimin negativ të dy gjërave ose koncepteve:

- *Shembuj: Qenin e du, macen se du; Une ty nuk du, une ty jom idhnu; Nuk e kam ba unë, ai e ka ba; mos bëtit ti mu, ti je e keqe.*

Mosha 5-7 vjeçare

Në këtë moshë fëmijët përdorin trajta më komplekse dhe të ndërtruara më mirë. Edhe këtu vazhdojnë qëndrimet e theksuara përmes emocioneve, por vërehet prania e të menduarit më racional dhe shpesh mohimi shoqërohet me arsyetim. Fjalitë mohore në këtë moshë përdoren për urdhra, por edhe për kërcënime. Këtu vërehen edhe pasaktësi në vetë (s'ka me lujtë ma me ty – në vend të s'kam), përdorime të trajtave dialektore ose të folmeve (*sum, spe, ncuk, e të tjera*).

- *Shembuj: Jo se ajo loder osht i keq, Jo se ajo mu niher mka bertiiiiit , edhe osht i keq, Jo une nuk bona kurgjoo, une se kom preeeek, Jo se nuk jom fmi, Jo se shume nxeht,*
- *Ma ka marre kukllen e nuk osht tu ma kthy; Jo spe du kerrin; ama telefonin; Shko prej shpies tem; mas hajde ma; Mos m'ba kaq shum pytjeeeee (i inatosur); S'ka me lujt ma me ty.*
- *Ncuk, duke tundur kokën; Jo qaq shumë; Hiq sum pelqen;*

Këtu paraqiten për herë të parë edhe ndajfolja kurrë, pjesëza mohuese as... as,

- *Nuk e kom pa kurrë; s'jom tu e gjetë librin; As dje nuk kemi pas shkolle.*

Mosha 8-11 vjeçare

Fjalitë mohore shkojnë duke u bërë më komplekse, por ndryshimi nuk përkon gjithaq me dallimin në moshë (siç ishte rasti me format më komplekse të pyetjeve).

Shembuj: Jo nuk shkoj, Jo dielli e kish nxe, Se msusja neve hiq detyra nuk na ka jep edhe une nuk po du me msu, Mu nuk um pëlqen,

Përvetësimi i gjuhës shqipe si gjuhë amtare nga pikëvështrimi i hipotezës së rendit natyror

*Shumë e keqe, Hiq se kam qef, Për mu nuk është. Jo nuk është qashtu!
Jo, nuk e di, Tenisi nuk më pëlqen, Jo unë nuk rri me bebe;*

Edhe në këtë moshë befason shkalla e përdorimit të trajtave dialektore dhe i të folmeve.

- *Mu nuk um pëlqen kafsha gjarpri, Mu s'um pëlqen landa e pundores; Ja,ja,ja; Nc; jo mor cfarë banketi; Nuk um halet dardha qaq.*

Aspekti – kohët e foljeve

Mosha 1-2 vjeçare

Nga 59 raste të analizuara për aspektin e përdorimit të foljeve, 27 nuk përdorin asnjë kohë, por përdorin pjesë të ligjëratës ose vetëm, ose të kombinuara me njëra tjetrën; 25 përdorin kohën e tashme në diatezën veprorë; 6 përdorin kohën e kryer ose një përzierje mes kohësh. Dhe një fëmijë përdor kohën më se të kryer, e cila ishte ose imitim, ose një rast i veçantë.

Diçka tjetër që vlen të përmendet është se fëmijët nga mosha 12 muaj deri në 20 muaj (sipas moshës së fëmijëve të vëzhguar) kryesisht përdorin vetëm kohën e tashme me diatezën veprorë. Rastet e tjera janë me fëmijë mbi dy dhe rreth tri vjeçarë, ku haset koha e kryer e thjeshtë ose në disa raste një përzierje mes këtyre dy kohëve.

Te fëmijët që nuk përdorin asnjë kohë vëzhgohet përdorimi i pjesëve të veçanta të ligjëratës. Fëmijët 1 muajsh e deri pa i bërë 2 vjet përdorin më shumë emrat (*mam, bab, depi, uj, mokat*) dhe pasthirrmat. Prej moshës 20 muajsh e tutje fëmijët përdorin më shumë sintagma emërore me mbiemra për të përshkruar ato që dëshirojnë (*babi mil, nga pejt, fjal e keqe*).

Mosha 3-4 vjeçare

Ndër 59 fëmijë të vëzhguar janë vërejtur këto trajta: 32 shembuj në kohën e tashme, 1 në kohën e pakryer, 11 në kohën e kryer të

thjeshtë, 25 në kohën e kryer, 12 në kohën e ardhme dhe në 10 raste nuk ishte regjistruar ndonjë shembull me rëndësi.

Nga këto, mund të thuhet se fëmijët 3-4 vjeç, në përputhje me teorinë e procedimit gradual, fillimisht e mësojnë përdorimin e kohës së tashme të foljes, pastaj të shkuarën dhe në fund të ardhmen. Shumica prej tyre kanë vështirësi në shqiptimin e drejtë të fjalëve. Disa syresh nuk bëjnë dallimin në mes të konceptit të kohës së shkuar dhe të ardhme, megjithëse disa i kanë përvetësuar këto koncepte. Kjo do të thotë se përafërsisht në këtë kohë fillon përvetësimi i konceptit të kohës te fëmijët e vëzhguar. Disa fëmijë përdorin vetën e tretë njëjës kur i referohen vetvetes. Në këtë moshë fëmijët kryesisht i përdorin elementet kryesore të fjalisë, ndërsa rrallë i përdorin ndajfoljet, fjalët strukturore, pjesëzat dhe lidhëzat.

Nga gjuha e përdorur e fëmijëve vërehet se prindërit nuk komunikojnë me fëmijët në gjuhën standarde e as që përdorin koncepte më komplekse. Ka të ngjarë që në komunikim me fëmijët e tyre prindërit të përdorin gjuhën e modifikuar ose gjuhën e fëmijës. Për shembull, të gjithë fëmijët përdorin trajtën e foljes ndihmëse kam (si në *kam me shku*) – në vend të ‘formës “do të” për formimin e trajtës së kohës së ardhme; ose përdorin ‘*jam kanë*’ në vend të ‘*kam qenë*’. Ky aspekt do të kërkonte hulumtim më të madh të formës dhe të përmbajtjes së komunikimit të prindërve me fëmijët.

Mosha 5-7 vjeçare

Ngatërrimi i trajtave kohore:

Gjatë hulumtimit të trajtave kohore për moshën 5-7 vjeçare janë hasur trajta më komplekse, por edhe ngatërrime të trajtave të përdorura kohore (kryesisht te mosha 5 vjeçare). Kjo tregon se fëmijët e kanë tejkaluar fazën e imitimit; kryesisht e kuptojnë konceptin e kohës, por kanë probleme me artikullimin dhe përdorimin e drejtë të trajtave kohore dhe lidhjen me kohën.

Shembuj të përdorimit të gabuar: *Dje kom me shku te Lisa; Dje kena me shku te dajt; Une jam kan neshel te dajt; Kur i bleve patikat? Qetash kemi shku; Aroni du akulllore; Ku ke shku nesër? Jom kon nesër; Ka me ardh dje te Kosova.*

Shembuj të përdorimit të drejtë: *Mesuesja na ka then mi be detyrat; Kam me shku te dajet; Jam kan ne shitore; Kam me shku papa me mamin; mami ka ku punë; Pak ma von vi; Kena mu knaq në pushim; E ka pa në film.*

Forma e të nxënit: imitim – gjeneralizim: Në këtë moshë vërehet kalimi nga të mësuarit nëpërmjet imitimit në gjeneralizimin e trajtave më komplekse, për shembull: ‘*Kom me ta këputë gjuhën*’, një shprehje kjo e mësuar me imitim nga prindërit ose nga mjedisi. Mirëpo, në anën tjetër, hasim reagimin origjinal të fëmijës ndaj veprimit të kuptuar: *Unë e mshefna gjuhën* – përgjigja me gjeneralizim (është mësuar si reagim ndaj kërcënimit dhe si rezultat i të kuptuarit të pasojave);

Mosha 8-11 vjeçare

Këtu vërehet përdorimi më i shpeshtë i formave të kohës së kryer, por edhe trajta më komplekse të kombinuara me mbiemra. Por, njëkohësisht, vërehet forcimi i trajtave dialektore dhe i të folmeve në vend të dobësimit të tyre.

Kështu, gjatë përcjelljes së 59 respondentëve të kësaj moshe janë hasur 14 raste të përdorimit të kohës së tashme; 2 të kohës më se të kryer; 19 të kohës së kryer; 5 të kohës së kryer të thjeshtë; 1 të kohës së pakryer; 7 të kohës së ardhme dhe në 15 raste ka qenë e vështirë të nxirren shembuj të vlefshëm.

Pra, për dallim nga fëmijët e moshave 3-4 dhe 5-7 vjeç, grupmosha 8-11 vjeçare përdor pothuajse të gjitha trajtat kryesore kohore. Respondentët e kësaj grupmoshe kanë shqiptim të mirë të fjalëve në përgjithësi. Mund t’i përdorin lidhëzat, si dhe janë të vetëdijshëm çka është ‘*dje*’ dhe ‘*nesër*’. Në

përgjithësi, dinë të dallojnë të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen.

Unë di ma shumë se ti me numëru (koha e tashme edhe krahasimi i mbiemrave); Unë kesh e bleoa; Kisha harru me ble ni laps; Msusja e ka shkrujtë; Mka msu; Jena kan; Kom shkru; Kom ba; Dje kam shku me lujt; Testin e matematikes e kam kry;
Unë do të punoj; Do të lexoj një lektyrë. Kum hangër picë; Gjyshi jem i ka pas dy grue (përdorim i gabuar i shumësit të emrit grua). Mam neser në ora 8 kam mu kan në shkollë; Shumë e mirë u kan koha sot; T'hanen kam me shku me lu basket

Po ashtu, nuk e vendosin vetveten në vetën e tretë njëjës siç ndodh tek moshat më të hershme.

Unë kam qenë dje të luaj futboll. Unë do të shkoj nesër në shkollë.

Megjithatë, edhe këtu vërehet mungesa e komunikimit të drejtë dhe përdorimi i fjalëve joadekuate apo jashtë standardit.

Aspekti: formimi i fjalive

Mosha 1-2 vjeçare

Në formimin e fjalive në këtë moshë shpesh haset përsëritja e një fjalie të mangët (telegrafike) ose përdorimi i vetës së tretë në vend të vetës së parë: *Jora ku?* (Jora ka shku). Fjalitë zakonisht përbëhen nga 1 ose 2 fjalë. Në sipërfaqe, shumica e fjalëve duken të palidhura dhe janë telegrafike. Për shembull, djegia e dorës është *xhixha*; fjalitë shpesh përbëhen nga një emër i vetëm: “mama”, “baba”, “kuku”, “Dada”, “Aba”, “Hala (Halla)” ose për kafshë të ndryshme “*mjau -mjau (maca)*”, “*hum- hum (qeni)*”. Fjalitë janë zakonisht në kohën e tashme, në vetën e parë dhe në formë eksklamative e urdhërore “*du çokolladë, jo, nuk po du, nuk po shkoj*”. Foljen e përdorin kryesisht në kohën e tashme; në të folur vërehen vështirësi në lidhjen e fjalëve dhe mungojnë lidhëzat e pjesëzat.

Mosha 3-4 vjeçare:

Në këtë moshë, fjalitë janë ende kryesisht në kohën e tashme. Megjithëse shtohet dukshëm numri i fjalëve dhe i pjesëve të ligjëratës (folje, mbiemra, fjalë strukturore), vërehet përdorimi i kundrinorëve e të tjera:

- *Unë e kum pa filmin; Unë e di ma mirë se ti.*
- *Pe fyj (fryj). Hajde t'perqafoj, t'qafi; Une e kom qendesen mamin e dyte; Ka shku lag (larg); Hekma zinxhirin, jom bo nuqe. Une du me lujt me kuklla. Me ka marr mari (malli).*

Fjalitë në këtë moshë fillojnë të shprehin kuptimin e kohës së kryer e të kohës së ardhme, paralelisht me përdorimin e trajtave kalimtare:

- *Kom me gjet gjyshe tjetër; Kom me ndrru në spital; Oj tete të ka hup djari (djali); Vi te ti nëse mi plotëson dëshirat; Msim me msu; ka me shku shkollë; kur ta vraj kamën mami fet ku e ke vra kamën e unë fam te ruga.*

Mosha 5-7 vjeçare

Tashmë, si rezultat i edukimit dhe i pjekjes kognitive, formohen fjali me më shumë gjymtyrë, më të përbëra dhe që përshkruajnë gjërat më hollësisht. Për shembull: *babi mka thane me shku drejt, mandej djathtas, mandej në kthesën e parë mu kthy majtas.*

Tani mendimet janë më komplekse dhe shprehen më saktë: *Msusja nuk mka pelqy. Une kaloj shumë mirë në shkollë. Edukatorja na ka mësu qysh me numëru; Shumë është leht; Unë i di numrat edhe në shqip edhe në anglisht.*

Mosha 8-11 vjeçare

Në këtë fazë, fëmijët përdorin trajta e fjali më komplekse, përfshirë edhe ligjëratën e zhdrejtë (*I thash mamit a bujna te dajt, thojke jo*) dhe ndonjëherë edhe fjalitë e bashkërenditura.

Shembuj: *Unë kom me shku në hanë kom mu bo astronaut. Jom biznesmen pe maj mallin me kamiona. Po dal jasht, po luj me top. Nuk po du me shku në Albi, du mi pa pinguinat. Shum po vonohesh. Mami i ka dy shoqe; Albina, po me bon shum nervoz. Une spo kom qka me bo. Kanihere pe rrej mamin. Kta veq mu po me bërtasin. Po du qaj. Spom shkohet. Po du mi vesh qeto tesha. Mkeni lodh me kto detyra. Unë jom spiderman. Llamburgjini kom me ble kur bohna i madh. Patika jordanka mi ka ble babi. Hajde lujna. I kena gjet ne zbritje.*

Siç vërehet nga shembujt e mësipërm, fjalitë e thjeshta mbesin megjithatë format më të shpeshta sintaksore për shprehjen e mendimeve. Një gjë tjetër që paraqitet me më shumë insistim në këtë fazë (dhe është shprehur edhe në shembujt e mësipërm) është forcimi i elementit dialektor në të folur. Paralel me dialektin dhe të folmet rajonale, aty -këtu hasim edhe përdorimin e standardit gjuhësor.

Une do të bëhem mjeke, ushtar, këngëtare, violoniste, futboller, infermiere. Ka ra borë. Kena msu për zgjedhimin e foljeve. Po du me ba një pyetje. Kena ba test

Aspekti: Përdorimi i trajtave të ndryshme

Mosha 1-2 vjeçare

Krahasimi i mbiemrave

Në këtë moshë mbiemri përdoret për të cilësuar emrin (edhe kur nuk e shoqëron atë). Nuk vërehet përdorimi i shkallës krahasore: *bukujose, e milë, buda, e kece, babi milë.*

Përemrat

Është e kuptueshme që në këtë moshë fëmijët janë të përqendruar në vetën e parë të përemrave (vetorë, pronorë) e të mbiemrave pronorë. Vërehen edhe format kalimtare (shih më poshtë *tu, e vet, ota, mue*). Shembuj: *Jemja, tu, jemi, e jemja, e vet, jem, ota (jotja), mue*.

Ndajfoljet dhe përemrat lidhorë

Në këtë moshë përdoret një spektër i gjerë i ndajfoljeve dhe i përemrave lidhorë (më shpesh *ku* dhe *kur*).

Shembuj të ndajfoljeve: *dje, sot, nesër, tash, tu, jashtë, neqël, qitu, pak, qum, larg, shum, kur*.

Format kalimtare

Te fjalët e paqarta në rrafshin fonetik kemi hasur që fëmijët, në fjalët që vazhdojnë me bashkëtingëllore, nuk mund ta përdorin shpesh tingullin /Sh/. Objektet shpesh i përshkruajnë në bazë të tingujve që lëshojnë (për shembull: *vetura - gang*) etj. Gjatë artikulimit të fjalëve përdorin vetëm tingujt më të zëshëm duke ndryshuar krejtësisht gjysmën e tingujve ose duke mos i përdorur fare:

- *Dotin, tuu, shojna, bola, pam, el, rlzu (rrëzuar), ljet, gangin, lad, oqt, pehen, pet, ka, ma, zhdu, kojna, bebi, mjau, bee, keli, ceni. Xhoni xhoni, jes papa ...*

Mosha 3-4 vjeçare

Te kjo moshë fillon aplikimi i krahasimit të mbiemrave, si dhe përdorimi i shkallëve të krahasimit. Në të vërtetë, më shumë mund të flitet për një vetëdijësim për konceptin e shkallëve të krahasimit, sesa për përdorim të mirëfilltë të tyre – domethënë vërtetohet se të kuptuarit i paraprin artikulimit. Kjo sepse, në vend të krahasimit *i mirë - më i mirë*, fëmijët në këtë moshë preferojnë të përdorin *shumë i mirë* ose *sa bukur* ose *sjam e total* –

jam e male; megjithëse, sado që rrallë, nuk mungojnë as trajtat si *ma i mav* (më i madh); *ma e mir, ma i folt* (më i fortë). Po ashtu, në këtë moshë paraqitet edhe përdorimi i më shumë se një mbiemri në një fjali – mendim (*e male, e tuqe*).

Krahasimi i mbiemrave bëhet duke përdorur numër të kufizuar të fjalëve dhe të formave; përdoren kryesisht ato që i dëgjojnë duke ua paravënë fjalën shumë mbiemrave: e madhe, e vogël, e mirë, e keqe, kurse fjalë të tjera janë shumë të rralla: *Sjam e total, jam e male; un jam i mav ai osht i vogej; un jam i madh sa ti, ma i folt se babi; ma e mir; qum bukul; Unë jam rritë ma e madhe, e të tjera si Je e keqe; butujose* (bukuroshe), *tutel* (kukull) e *male e tuqe; laki zi; un jo e vogël; sa e bukur; filma vizatimor* (me siguri me imitim); *unt un; ni keqee; e bukur, e milë*.

Përemrat:

Në këtë moshë fëmijët fillojnë të përdorin më shumë përemra dhe jo vetëm ata vetorë, por edhe lloje të tjera, si për shembull ata dëftorë. Njëkohësisht, fillojnë të artikulojnë edhe shumësin e përemrave dhe, po ashtu, përdorimin e tyre në gjuhën standarde. Dallojnë gjithashtu edhe gjininë dhe numrin, edhe pse ende nuk e përdorin në rastet e duhura. Këtu hasim në përdorimin e përemrave në gjini dhe në numër dhe, po ashtu, të shprehur në dy e më shumë forma (shpesh kalimtare) të të njëjtit përemër: *jemja, jem, em, jeme, jemi*. Është paksa befasuese se sa i përket përemrave nuk vërehet ndonjë përparim i konsiderueshëm nga mosha 1-2 vjeçare. Shembuj:

- *Ti, un, aj, ajo, na, atë, këtë, kjo, mu, kto, ty*
- *Jemja, jem, em, mijat, jeme, jemi, tonden, e vet, mue.*

Ndajfoljet:

Këtu është hasur edhe përdorimi i shkallës krahasore të ndajfoljeve, ndërsa më shpesh përdoren ndajfoljet e kohës, vendit e të sasisë (*ma anej, veq pak*). Shembuj: *Nalt, nesra, qeshtu,*

Përvetësimi i gjuhës shqipe si gjuhë amtare nga pikëvështrimi i hipotezës së rendit natyror

qetash, larg, kur, ma von, nesar, ku, tash, neshel, ma anej, qetu, pak, veq pak, dje, shum.

Format kalimtare:

Edhe në moshën 3-4 vjeçare fëmijët artikulojnë fjalët nëpërmjet tingujve më të zëshëm. Po ashtu, në këtë moshë fëmijët fillojnë njohjen e më shumë objekteve, duke i përshkruar në mënyrën që ata e dinë dhe e dëgjojnë. Këto forma kalimtare kuptohen pothuajse pa përjashtim dhe përdoren me simpati nga familjarët. Për shembull, fjala /tutël/ (kukull) thuhet në një familje se është përdorur njësoj edhe nga motra më e madhe dhe përdoret edhe të tjerët në familje.

- *Jonat, arll, xysi, ydyn, shlojn, las, lak, tutël, sangalep. Naqa, ere, fam, doa, gjogi, mquqja, dili, koka, pija.*

Mosha 5-7 vjeçare

Krahasimi i mbiemrave

Në këtë moshë mbiemrat përdoren pothuajse rregullisht, mirëpo karakteristikë e kësaj moshe është se shumë rrallë aplikohet krahasimi i mbiemrave. Shembuj: *Keq, e mil, djali i keq, e mirë, I vogël, të gjatë, të njëjtë, e kuq.*

Përemrat:

Përemrat vetorë e pronorë përdoren në këtë moshë pa gabime. Megjithëse, edhe këtu vërehet përdorimi i shpeshtë i trajtave dialektore (*jemja*). Ilustrime: *unë, ti, ai, ne; por edhe im – imja, yt – jote etj.*

Ndajfoljet:

Ndajfoljet përdoren në masë të madhe në këtë moshë. Kjo mund të reflektojë zotërimin nga ana e fëmijëve të konceptit të kohës dhe të vendit (përfshirë rregullën e konservimit – kur një objekt i madh në largësi nuk duket më i madh se objektet e

vogla në afërsi). Mirëpo, sikurse te mbiemrat, lë përshtypje përdorimi shumë i kufizuar i shkallëve krahasore dhe sipërore edhe në rastin e ndajfoljeve. Po ashtu, lë përshtypje përdorimi, deri në një masë, i trajtave dialektore (shih më poshtë). Njësoj sikurse ndajfoljet, edhe përemrat lidhorë (*ku, kur, pse*) vazhdojnë të jenë në përdorim të gjerë dhe të drejtë te fëmijët e kësaj moshe: *Sot, dje, nesër, atje, nalt-lart, larg, pram-mbrëmë, shumë, shumë mirë, sod-sot, tash, kurrë, sonte, niher-njëherë, kthtu-ktu, lart, posht.*

Format kalimtare:

Këtu vërehen fjalë të pakuptueshme për intervistuesin, por që me siguri bartin kuptim për fëmijën dhe familjen, si forma kalimtare drejt një kuptimi ose funksioni të caktuar. Shembuj: *Mshueshka, qatmakin, e tuq.* Këtu fjala *e tuq* – i referohet ngjyrës së kuqe. *Mshueshka* – mësueses, ndërsa fjala *qatmakin* mund të shënjojë çamçakëzin.

Mosha 8-11 vjeçare

Në këtë moshë fëmijët përdorin drejt shumicën e pjesëve të ligjëratës. Te mbiemrat e te ndajfoljet vërehet përdorimi i shkallëve të krahasimit, zgjerohet lista e përemrave të përdorur në mënyrë të drejtë dhe fillojnë të zhduken fjalët e pakuptueshme.

Aspekti: Përdorimi dhe ndikimi i dialektit

Mosha 1-2 vjeçare

Në këtë moshë nuk është e qartë nëse shqiptimet dhe përdorimi i trajtave të gabuara është rezultat i përdorimit të trajtave dialektore (të folmeve), gabime tipike të moshës apo trajta kalimtare. Në disa raste vërehet se është fjala për përdorim të trajtave dialektore (materiali gjuhësor i dëgjuar në rrethin e

fëmijës). Të këtilla janë rastet e përdorimit të trajtës *du* në vend të *dua*, *kojna* në vend të *shkojmë*, *tamin* në vend të *qumështin*, *lu* në vend të *luaj* e të tjera. Në tri rastet e fundit kemi të bëjmë si me trajta dialektore (*tamlin* – *shkojna*), ashtu dhe me trajta kalimtare (*tamin* – në vend të *tamlin* dhe *kojna* në vend të *shkojna*).

Shembuj të tjerë: *Mami kojna papa; Mami vi une?* (A mund të vij unë?); *Unë koj* (unë po shkoj); *Du lu top; Du pi tamin* (qumështin); *Une tat kuka* (unë fle me kukulla); *Duu mami* (të dua mami).

Përdorimi *une tat kuka* është trajtë e pastër kalimtare, pasi që nuk është një formë e huazuar nga dialekti e as nga e folmja e ndonjë ane. Përkundrazi, duket se forma kalimtare *tat* e fëmijëve e ka ndikuar të folurit e të rriturve, pasi që shpesh, në situatat më të ndryshme, hasen formulime me fjalën *tat* (për gjumë) në gjuhën e të rriturve!

Mosha 3-4 vjeçare

Format dialektore në këtë moshë janë rezultat i gjuhës së përdorur nga familja dhe rrethi në të cilin rritet fëmija. Gjatë hulumtimit nuk është vërejtur ndonjë ndikim i çerdhes ose i kopshtit në gjuhën e përdorur nga fëmijët e kësaj moshe. Kjo mund të ndodhë ose për shkak të mospërfshirjes së duhur të fëmijëve në institucionet parashkollore, ose si rezultat i gjuhës (dialekt ose e folme) të përdorur në këto institucione nga edukatorët. Në këtë moshë fillojnë të dallohen përdorimet dialektore nga format kalimtare, si për shembull: *Jo gabim e ki; Nuk është qështu; Un e kum pa filmin*. Sipas të gjitha gjasave trajtat e të folmeve vendore *ki*, *kum* dhe *qështu* mund të vazhdojnë të përdoren nga fëmija edhe pas vijimit të shkollimit.

Në anën tjetër, hulumtuesit kanë regjistruar edhe trajta të rregullta të standardit gjuhësor në këtë grupmoshë: *Jo, nuk dua; Nuk ta jap; Nuk të thirra; Nuk dua të luaj; Mos ma merr*. Në këto

pesë fjali hasim vetëm në një përdorim dialektor (*luj*). Nga kjo vërejmë se në të shumtën e rasteve, familja ndikon në përdorimin e trajtave jostandarde gjuhësore në të folurit e fëmijëve të moshës parashkollore.⁵

Mosha 5-7 vjeçare

Te kjo grupmoshë vërehet qartë ndikimi i shkollimit (sidomos klasa parafillore dhe klasat e para të shkollimit). Fëmijët përdorin trajta më të drejta dhe më të plota. Në përgjithësi, shembujt e mbledhur tregojnë për një kapërcim cilësor pozitiv në të shprehur dhe në trajtat e përdorura. Te kjo moshë, pos të folurit më të rregullt e më të plotë, duket se reflektohet edhe edukata e fituar në shkollë (*Mos rrej se s'bën*).

Shembuj për ilustrim:

- *Mami a t'dal me lujt me top*", "Mami a më dergon në shkollë?", "Mami kur kena me shku te dajt?", "Kur vjen babi?
- *Kur t'rritna dua t'bëhem ose mësuese ose profesoreshë; Kur jam kan e vogel jam qu n'katër n'mëngjes; Dje e kemi msu njeriu dhe natyra.*
- *E ti kush je? Qysh e ki emrin? Kush të pëlqen ty ma shumë? A keni me ardh nesër?*
- *Shumë është leht; Unë i di numrat edhe në shqip edhe në anglisht; Mos rrej se s'bën;*

Mirëpo, njëkohësisht vërehen edhe elemente jo shumë të rralla të përdorimit të trajtave dialektore:

- *Kur është mas pushimit? Mos m'ba kaq shumë pyetjeeee (i inatosur); S'ka me lujt ma me ty; Gabim e ki, s'është qështu; Nuk e kum ba unë; Unë ngaj ma shpejt se ai; Ama ta mbrehi; E ka pa në film; Idhnohum e apet nrequm; Ka shku baci Mendi te dajt; E kum pas shoqe prej klasës parashkollor.*

⁵ Ndonjë studim tjetër mund të hulumtojë masën e ndikimit të faktorëve të ndryshëm: familje, institucion parashkollor, mjedis në trajtat e përdorura në të folurit e fëmijëve.

Mund të supozojmë se kjo ndodh për arsye e rrethana individuale të fëmijës, por edhe nga gjuha e përdorur nga familja, edukatorja, mësuesi etj. Megjithatë, si rregull, kjo moshë tregon përparimin më të madh në përdorimin e standardit gjuhësor, krahasuar me të gjitha grupmoshat e tjera.

Mosha 8-11

Në këtë grup vërehen dy tendenca njësoj të fuqishme: edhe respektimi i standardit, edhe përdorimi më i madh i trajtave dialektore dhe i të folmeve. Një shqyrtim më i kujdesshëm i kësaj grupmoshe mund të japë indikacione me interes edhe për cilësinë e shkollimit në Kosovë në nivelin përkatës (klasa 3-6).

Përmbledhje e rezultateve:

Tabela në vijim jep një përmbledhje të paraqitjes së parë të trajtave e të kategorive kryesore të aspekteve të hulumtuara.

Tabela 3: Paraqitje më e përmbledhur e të gjeturave:

Aspekti	Pyetje	Mohim	Kohët e foljeve	Fjalitë	Trajtat (mbiemra / ndajfoljet)	Dialekti / standardi
Mosha						
1-2	Pjesëza Kërkesa Pasthirrma	Joverbale, mimikë, jo, nuk, pasthirrma	Infinitiv E tashme Një fjalë	Fjali të mangëta S - P	Mbiemrat bazë Përemrat vetorë Fjalët pyetëse	Format kalimtare Pak dialekt
3-4	Pyetje të thjeshta a ... Kërkesa	Joverbale Jo, nuk, s + folje	E tashme Paraqiten trajtat tjera me gabime	Fjali të mangëta 1-5 fjalë S-P + IO-O	Krahasohen trajtat bazë (Mb. e Nd.) Përemrat pronorë - jemja	Dialekt Forma kalimtare Pak standard

					Fjalët pyetëse: Pse, Kush	
5-7	Pyetje më komplekse Fjalët pyetëse	Fjali mohore të thjeshta dhe më komplekse	Përdori mi kohës së shkuar dhe i kohës së ardhme	Fjali më të plota Edhe të përbëra Mungojnë fjalitë komplekse	Krahasi mi i mbm. Krahasi mi i ndf. Mbiemrat pronorë	Standardi gjuhësor Pak dialekt
8-11	Pyetje të plota Trajtat jo shumë komplekse	Fjali mohore të thjeshta dhe më komplekse	Përdori mi kohës së shkuar dhe i së ardhmes Mungojnë pësorja, ligjërata e zhdrejtë, mënyrat	Mungojnë fjalitë e përbëra me bashkërenditje dhe nënrenditje	Krahasi mi i mbm (shk. Krahason e) Krahasi mi i ndf. Mbiemrat pronorë dhe shumë përemra	Nuk është e qartë

Konkluzionet

Në fund mund të përfundojmë se, sikurse në gjuhën angleze, edhe në gjuhën shqipe duket se ekziston një rend natyror i përvetësimit të trajtave, morfemave dhe të funksioneve gjuhësore.

Bazuar në rezultatet e hulumtimit, vërehet lëvizje dhe përparim nga trajtat e thjeshta kah ato më komplekse në përputhje me moshën e fëmijëve të vëzhguar, në pajtim me teorinë e procedimit gradual të Pienemann. Më konkretisht, janë konstatuar këto procese dhe tendenca në zhvillimin e të folurit të fëmijëve të vëzhguar:

- Prej shprehjes joverbale – emocionale kah të menduarit / artikulimi racional dhe verbal (në përputhje me fazat e zhvillimit kognitiv).
- Prej formave të thjeshta shpesh kalohet nëpër format kalimtare, për të përfunduar pastaj në standard gjuhësor ose në forma dialektore.
- Mungesë e formave më komplekse (dëshirore, habitore, pësore, ligjëratë e zhdrejtë e të tjera). Nëse merren për kriter fazat e Pienemann të përvetësimit të gjuhës (shih më lartë në kornizën teorike), atëherë del se gjatë tërë vëzhgimit fare pak fjali të përbëra me fjali të varura ose të bashkërenditura.
- Mungesë relative e koncepteve më të avancuara (edhe të grupmosha 8-11). Shumicën e diskurseve të regjistruara i karakterizon një fjalor i kufizuar si për nga përmbajtja, ashtu dhe nga forma.
- Përsëritja e disa formave dialektore (*kum, qështu, zdu, shkojna*, etj): kjo pjesë përbën edhe një burim shqetësimi për shkak të ngurtësimit të formave dialektore ose të të folmeve.
- Roli i kombinuar i shkollës: në njërën anë, duke afirmuar përdorimin e standardit gjuhësor (sidomos në vitet e para të shkollimit), por edhe në ngurtësimin e trajtave dialektore dhe të folmeve (në klasat e shkollës së mesme të ulët) në anën tjetër.
- Rëndësia e shtuar e imitimit në përvetësimin e trajtave dialektore etj. (shih paraqitjen e përmbledhur tabelore të

të gjeturave kryesore më lart). Shumica e materialeve të regjistruara mund të gjejnë burimin e përvetësimit në imitim dhe jo në gjeneralizim ose në përpjekje sistematike të prindërve, të mjedisit e madje as të mësimdhënësve.

Nëse do t'u referoheshim shkurtazi pyetjeve kërkimore, atëherë mund të thuhet se sikurse në rastin e gjuhës angleze, ekziston një rend i natyrshëm i përvetësimit të gjuhës shqipe si gjuhë amtare. Mirëpo, në bazë të këtij hulumtimi të parë, nuk mund të konstatohen ngjashmëritë dhe dallimet në mes të trajtave të përvetësuar në këto dy gjuhë. Kjo mbase edhe për shkak të dallimeve të theksuara ndërmjet këtyre dy gjuhëve në formimin e trajtave dhe të aspekteve të ndryshme (anglishtja si gjuhë analitike dhe shqipja si gjuhë me element dominues sintetik). Parimi në gjuhën shqipe është se shkohet prej trajtave më të thjeshta kah ato më komplekse: prej një fjale kah më shumë fjalë; prej fjalëve individuale kah lidhja e tyre në tërësi më komplekse kuptimore; prej kohës së tashme kah trajtat më komplekse (megjithëse ato më komplekset, si kushtorja e habitorja, hasen shumë rrallë ose fare); prej përshkrimit të emrit me mbiemrin bazë, përmes krahasimit të dy mbiemrave bazë (*unë milë - ti keq*) e deri te përdorimi i shkallës krahasore (rrallëherë përdorimi i shkallës sipërore); prej pyetjeve e kërkesave joverbale ose me një fjalë kah format më komplekse të pyetjeve, e kështu me radhë. Kjo tendencë përshtatet me zhvillimin kognitiv të fëmijëve, mirëpo vërehen edhe variacione varësisht nga: mjedisi ku rritet fëmija, cilësia e materialit gjuhësor të cilit i ekspozohet fëmija, shkallës së inteligjencës së fëmijëve individuale, punës dhe kujdesit të prindërve për zhvillimin gjuhësor të fëmijës, cilësisë së shkollimit e të mësimdhënies etj.

Dy gjëra me rëndësi kanë dalë gjatë hulumtimit, të cilat nuk ishin planifikuar në fillim:

1. Përderisa në gjuhën angleze ekziston dhe aplikohet një standard gjuhësor në të folur dhe në të shkruar, në gjuhën shqipe përdorimi i dialektit, e madje edhe i të folmeve, ka dalë si element me rëndësi i procesit të përvetësimit të gjuhës amtare.
2. Në gjuhën shqipe rrallë ose asnjëherë nuk kemi hasur përdorimin e trajtave më komplekse morfologjike e sintaksore. Fëmijët kufizohen në përdorimin e fjalive të thjeshta dhe të tri ose katër trajtave themelore të kohës; rrallëherë përdoren trajtat sipërore të mbiemrave; si dhe, fëmijët zotërojnë një vokabular të kufizuar të fjalëve (edhe në rastet kur vëzhgohen fëmijët e moshës mbi dhjetëvjeçare).

Rrjedhimisht, aktualizohet çështja e cilësisë së materialit gjuhësor, të cilit i ekspozohen fëmijët në familje e në mjedisin që i rrethon, si dhe cilësia e shkollimit dhe e mësimdhënies që ofrohet në shkollat kosovare. Këto çështje, e në veçanti kontributi i shkollës në përvetësimin e gjuhës shqipe si gjuhë amtare në Kosovë, do të duhej të ishin objekt i një studimi më të thellë.

Referencat

Akademia e Shkencave e Shqipërisë. (2002). *Gramatika e Gjuhës Shqipe*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

Bloom, L. (1991). *Language Development from two to three*. New: Cambridge University Press.

Bloom, L. S. M. (1982). Wh-Questions: Linguistic Factors that Contribute to the Order of Acquisition. *Child Development*, 1084-1092.

Bokshi, B. (1980). *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*. Prishtine: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.

Brown, R. (1973). *A first Language*. Cambridge, MA: Harvard University Press.

Burt, H. C. and Dulay M. K. (1974). Natural Sequences in Child Second Language Acquisition. *Language Learning*, 37-53.

Burt, H. C. and Dulay M. K. (1975). A new approach to discovering universal strategies of child second language acquisition. In (. A. Linguisti, *Developmental Psycholinguistics: Theory and Applications*. (p. 209-233). Washington: Georgetown University Press.

Creswell, J. W. (2012). *Educational Research: Planning, Conducting and Evaluating Quantitative and Qualitative Research*. Boston: Pearson.

DeKeyser, R. (2003). Implicit and Eplicit Learning . In C. D. Long, *Handbook of Language Acquisition* (p. 313-349). Malden, MA: Blackwell.

Demiraj, S. (1988a). *Gjuha shqipe dhe historia e saj*. Tiranë: Shtepia Botuese e Librit Universitar.

Demiraj, S. (1988b). *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Prishtina: Rilindja.

Dorgeloh, H. (2009). Syntax. In S. Bendella, *Introduction to English Language and Linguistics - Reader* (p. 23-28). SemanticScholar. Tratto da <https://pdfs.semanticscholar.org/c0a1/c3cf559427e80f27ddae69984519029f1765.pdf>

Ellis, R. (2009). Investigating Learning Difficulty in Terms of Implicit and Explicit Knowledge. In S. L. Rod Ellis, *Implicit and Explicit Knowledge in Second Language Learning and Testing* (p. 143-167). Bristol, Buffalo, Toronto: Multilingual Matters.

Përvetësimi i gjuhës shqipe si gjuhë amtare nga pikëvështrimi i hipotezës së rendit natyror

Fraser, C. U. B. (1963). Control of Grammar in Imitation, Comprehension, and Production. *Journal of Verbal Learning and Verbal Behavior*, Vol. 2, (Iss. 2).

Frey, L. R. (1999). *Investigating communication: An introduction to research*. Boston: Allyn & Bacon.

Fry, C. (2018, November). Second Language Acquisition Krashen and His Critics. *University study document - Anth 6800*. East Bay: California State University .

Goldberg, A. E. (2006). *Constructions at work: The nature of generalization in language*. Oxford: Oxford University Press.

Ismajli, R. (2003). *Standarde dhe Identitete*. Pejë: Dukagjini.

Kessler, C. and Idar, I. (1977). The acquisition of English syntactic structures by a Vietnamese child. *Los Angeles Second Language Acquisition Forum*.

Krashen, S. (2009). *Principles and Practice of Second Language Acquisition* (Internet edition ed.). San Diego: University of Southern California.

Lightbown, P. M and Spada N. (2013). *How Languages are Learned*. Oxford: Oxford University Press.

Meyer, G. (1883). Albanesische Studien I. Die Pluralbildungen der albanesischen Nomina. *Sitzungsberichte der philosophisch-historischen Classe der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften*, 104, 257-362.

Pedersen, H. (1894). Bidrag til den albanesiske Sproghistorie. In *Festskrift til Vilhelm Tomsen*. Kopenhagen: Gyldendal, 1894, pp. 246-57. (p. 246-57). Kopenhagen: Gyldendal.

Piaget, J. (1959). *The Language and Thought of the Children*. New York and London: Routledge .

Pienemann, M. (2005). An Introduction to Processability Theory. In M. Pienemann, *Cross-Linguistic Aspects of Processability Theory* (p. 13). Amsterdam: John Benjamins.

Pienemann, M. (2008). A brief Introduction to Processability Theory . In J.-U. Keßler, *Processability Approaches to Second Language Development and Second Language Learning* (p. 9-31). Newcastle: Cambridge Scholars Publishing.

Pritchard, A. (2009). *The Way of Learning*. London & New York: Routledge.

Quirk, R. S. G. (1992). *A Grammar of Contemporary English*. Harlow, UK: Longman.

Villiers, J. G. de and Villiers, P. A. de. (1978). *Language Acquisition*. Cambridge, Mass: Harvard University Press.

Wode, H. (1981). Language acquisitional universals: A unified view of language acquisition. In W. H. *Native Language and Foreign Language Acquisition* (p. 218-34). New York: New York Academy of Sciences: Annals of the NYAS.